



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-1171-2-1-1/C1038
14 Nr. 448/25
Dt. 12.06.2025

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë me një O.E.)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor Për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. Grup i Operatorëve Ekonomik Al Group PRO SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; ZEROLINE SH.P.K., Swiss Village nr,7, 10000, Prishtinë, Kosovë, Personi kontaktues: **Gezim Sylaj**, Emri i kompanisë: **Al Group PRO SH.P.K.** Numri fiskal: **811344613**
Selia: **Swiss Village nr,7, 10000, Prishtinë, Kosovë**, në tekstin e mëtejshëm: **Kryesi i Shërbimeve**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Hartimi i projekteve për A.K. - Vushtrri, me numër identifikues:

Nr1 i prokurimit	VU644-25-1171-2-1-1
Nr i brendshëm	VU644-25-06-2-1-1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lëndë e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga Kontraktuesit, si vijon: **Hartimi i projekteve për A.K. – Vushtrri**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-25-1171-2-1-1**.
- 1.2 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.
- 1.3 Kontrata është me çmime për njësi, ndërsa fillon së zbatuari ditën e nesërme pas nënshkrimit të saj dhe do të zgjasë deri më **11.06.2028**. Kontrata do të ndërpritet sipas fuqisë ligjore pas skadimit të datës së validitetit të saj. Megjithatë nëse “ Urdhërblerja “ apo “ Porosia “ është dhënë pakë kohë para se Kontrata Publike Kornizë të skadoi, dërgesa dhe / ose pranimi i shërbimeve mund të bëhet pas datës së skadimit të afatit të Kontratës Publike Kornizë.
- 1.4 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj dhe / ose të kryej shërbime në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kryesi i Shërbimeve, duke specifikuar listën me sasitë e shërbimeve përkatëse dhe / ose kryrjen e shërbimeve të saktësuara si në Flet porosi.
- 1.5 Shërbimet të cilat paraqesin lëndë të kësaj Kontrate Kornizë janë, si vijon :

Ky AP Ka të bëjë me Kryerjen e shërbimeve për projektimin e projekteve si vijon

1. Projektimi i projekteve të Infrastrukturës
 2. Projektimi i projekteve për ndërtesa dhe
 3. Projektimi i projekteve urbane,
- Aneksi nr.1 dhe Listës për Përshkrimin e Çmimeve.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit është 825.00,00€ . Ndërsa Vlerat e parashikuara të kontrates për sesilin vitë është me sa Vijon Për Vitin 2025 - Vlera e Parashikuar është 275,000.00€, Për Vitin 2026 - Vlera e Parashikuar është 275,000.00€ dhe Për Vitin 2027- Vlera e Parashikuar është 275,000.00€

- 1.6 Kualiteti i kontrollit të ekzekutimit të shërbimeve, si në cilësi ashtu edhe në sasi, do të bëhet në pajtim të plotë me ecurinë e saktësuar si në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit dhe në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë e Dosjes së Tenderit.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim dhe/ ose përfundim të ekzekutimit të shërbimeve do të jetë sipas Planit të Menaxhimit të Kontratës dhe Porosive të dhëna nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, bazuar në një afat të arsyeshëm kohorë.
- 2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë vendi i saktësuar nga Menaxheri i Kontratës – Komisioni i Pranimit të shërbimeve i Autoritetit Kontraktues – Njësisë Kërkuese, që sipas rregullit duhet të jenë : Drejtoritë Komunale të A.K. - Komunës së Vushtrrisë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet për njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kryesi i Shërbimeve, që përbën pjesë përbërëse dhe të pandashme të kësaj Kontrate Publike Komizë.
- 3.2 Vlera e parashikuar e Kontratës është : 825.000,00€ (Tetëqindnjëzetepesmijë/00 Euro). A.K. mundë të porosisë shërbime më së shumti deri në vlerën e prashikuar, edhe më pakë, ndërsa asesi të tejkaloi këtë vlerë.
- 3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues mundë t'ia paguaj Kontraktuesit, pas kryerjes së shërbimeve të porositura sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës të Shërbimeve i Autoritetit Kontraktues.
- 3.5 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kryesi i Shërbimeve të ketë përfunduar gjitha shërbimet e porositura prej Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

- 3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

- 3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Ferit Idrizi
Pozita:	Drejtor për Prokurim Publik	Pozita:	Kryetar i Komunës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2025	Data:	12.06.2025
Vula:		Vula:	



Për Kontraktuesin:

Emri:	Gëzim Sylaj
Pozita:	Përfaqësues i Kryesit të Shërbimeve
Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2025
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Projektin: Hartimi i projekteve per nevoja te Komunes						
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një me TVSH	TVSH	Totali me TVSH
A Hartimi i projekteve ideore - duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.						
1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	2.00 €	0.31 €	2.00 €
2	Punimi i projektit ideor –faza e Statikës (konstrukcioni dhe stabiliteti i objektit)	m ²	1	0.20 €	0.03 €	0.20 €
3	Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve –(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit).	m ²	1	0.20 €	0.03 €	0.20 €
4	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energjetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ²	1	0.20 €	0.03 €	0.20 €
5	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike – instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike.	m ²	1	0.20 €	0.03 €	0.20 €
6	Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	2.00 €	0.31 €	2.00 €
A	TOTALI :{1 deri 6}			A		4.80 €
B Hartimi i projekteve kryesore - duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.						
1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	8.60 €	1.31 €	8.60 €
2	Punimi i projektit kryesor - Konstrukcioni dhe stabiliteti i objektit (llogaria statike).	m ²	1	2.00 €	0.31 €	2.00 €
3	Punimi i projektit kryesor - Shkallevë emergjente te objekteve	cope	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
4	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - energjetika instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
6	Punimi i projektit kryesor të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike , klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
7	Punimi i projektit kryesor të instalimeve - Ashensoreve te ndryshem dhe shkallevë levizese.	cope	1	0.04 €	0.01 €	0.04 €
8	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	2.50 €	0.38 €	2.50 €
9	Punimi i projektit kryesor – Rrenimi i objekteve.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
B	TOTALI :{1 deri 9}			B		18.14 €
C Hartimi i projekteve për renovim - duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.						
1	Incizimi detal i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	6.00 €	0.92 €	6.00 €
2	Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	12.50 €	1.91 €	12.50 €
3	Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
4	Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
5	Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
6	Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
7	Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnizues i ujësjellësit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m'	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
8	Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m'	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
C	TOTALI :{1 deri 8}			C		24.50 €
	TOTALI (A + B + C) :					47.44 €

D	Hartimi i projekteve për Terene Sportive të hapura - duke përfshirë edhe inçizimin e gjendjes në teren.					
1	Projektimi i tereneve sportive - të hapura	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
2	Projektimi i shesheve (me fontana, gjelbrim, parkingje, shetitore etj.)	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
3	Projektimi i parqeve, kendeve për fëmijë etj.	m ²	1	3.00 €	0.46 €	3.00 €
D	TOTALI :{1 deri 3}			D		5.00 €

E	Hartimi i projekteve për Rugë dhe objektet e rrugës - duke përfshirë edhe inçizimin e gjendjes në teren , dhe LIDAR					
1	Projektimi i rrugëve	m ²	1	9.30 €	1.42 €	9.30 €
2	Projektimi i trotuareve	m ²	1	3.70 €	0.56 €	3.70 €
3	Projektimi i Urave deri 10 m	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
4	Projektimi i Urave mbi 10 m	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
5	Projektimi i Mureve Mbrojtëse nën 2m lartësi	m ²	1	0.60 €	0.09 €	0.60 €
6	Projektimi i Mureve Mbrojtëse mbi 2m lartësi	m ²	1	0.60 €	0.09 €	0.60 €
7	Projektimi i rrethojave të oborreve apo parcelave.	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
8	Projektimi i sinjalizimit të rrugëve	m ²	1	2.50 €	0.38 €	2.50 €
9	Projektimi për rregullimin e nyjeve të komunikacionit, rreth-rotullimeve etj.	cope	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
10	Projektimi i mbikalimeve	cope	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
11	Projektimi i nenkalimeve	cope	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
12	Projektimi i parkingjeve të hapura.	m ²	1	2.00 €	0.31 €	2.00 €
E	TOTALI :{1 deri 12}			E		24.70 €

F	Hartimi i projekteve për Trajtim të Ujërave - duke përfshirë edhe inçizimin e gjendjes në teren ,dhe LIDAR					
1	Projektimi i Kanalizimit Fekal	m ²	1	8.90 €	1.36 €	8.90 €
2	Projektimi i Kanalizimit Atmosferik	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
3	Projektimi i Rrjetit të Ujësjellsit	m ²	1	3.50 €	0.53 €	3.50 €
4	Projektimi i shtratit të perroit / lumenjeve	m ²	1	3.50 €	0.53 €	3.50 €
5	Projektimi i Rezervarve të Ujitë	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
6	Projektimi i Kanaleve Ujitëse me elemente përcjellese	m ²	1	1.00 €	0.15 €	1.00 €
7	Rrjetit i Kanalizimit Fekal ekzistues - digjitalizimit i rrjetit të kanalizimit	m ²	1	1.90 €	0.29 €	1.90 €
8	Rrjetit të Ujësjellsit ekzistues - digjitalizimit i rrjetit të Ujësjellsit	m ²	1	2.00 €	0.31 €	2.00 €
F	TOTALI :{1 deri 8}			F		22.80 €

G Hartimi i projekteve për Rrjetet Elektrike, Nriqimet Publike - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në teren.						
1	Projektimi i rrjetit elektrike dhe ndërcimit publik	m ²	1	2.80 €	0.43 €	2.80 €
G	TOTALI :{1 deri 1}			G		2.80 €
	TOTALI (D + E + F + G) :					55.30 €

Punimi i Elaborateve për nevojat e Autoritetit Kontraktues (Varesisht prej detyres projektuese dhe nevojave të AK)						
H						
1	Hartimi i Elaboratit kundër zjarrit.	m²	1	8.00 €	1.22 €	8.00 €
2	Projekti i shpronësimit (Elaboratet e shpronësimit)	m²	1	8.00 €	1.22 €	8.00 €
H	TOTALI :{1 deri 2}			H		16.00 €
	TOTALI (H) :					16.00 €

Rikapitullim i Përgjithshëm				Çmimi total
1	Totali nga (A+B+C): i projektimit për të gjitha pozicionet	50%		23.72 €
2	Totali nga (D+E+F+G): i projektimit për të gjitha pozicionet	45%		24.89 €
3	Totali nga (H): i projektimit për të gjitha pozicionet	5%		0.80 €
Çmimi total				49.41 €

Vrejtje:

- Të plotësohet kolona : Çmimi për njësi , tvsh , totali me tvsh
- Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjësime nese çmim është 0.00 edhe në tvsh.
- Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuar në Kosovë
- Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Pagesat do të bëhen vetëm në bazë të porosisë nga AK (Detyrës Projektuese nga ana e Menaxherit të Kontratës. Detyra projektuese do të përbëjë pozicionet e paramasës së mësipërme të cilat pozicione do të paguhën për projektin në fjalë).


Identifikim i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Al Group Pro SHPK
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:	Gëzim Sylaj
Nënshkrimi:	
data:	07.04.2025



Tabela e kalkulimit të çmimit për Kontrat Publike Kornizë - Shërbime - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar), sipas kategorive ku vlera e parashikuar e kontratës është 825,000.00 Euro							
Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE							
PËRSHKRIMI I POZICIONEVE							
MBIKQYRJA E PROJEKTEVE INVESTIVE							
A	KATEGORIA A+B+C=50%						
Pos	Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 50% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet të shpenzohet për kategorinë A + B+C
A	Hartimi i projekteve ideore - duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes në teren.						
1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m2	1.00	2.00	2.00		
2	Punimi i projektit ideor –faza e Statikës (konstruksioni dhe stabiliteti i objektit)	m2	1.00	0.20	0.20		
3	Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve –(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit).	m2	1.00	0.20	0.20		
4	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energjetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m2	1.00	0.20	0.20		
5	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike – instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike.	m2	1.00	0.20	0.20		
6	Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes në teren.	m2	1.00	2.00	2.00		
B	Hartimi i projekteve kryesore - duke përfshi edhe ingjizimin e gjendjes në teren.						
1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m2	1.00	8.60	8.60		
2	Punimi i projektit kryesor - Konstruksioni dhe stabiliteti i objektit (llogaria statike).	m2	1.00	2.00	2.00		
3	Punimi i projektit kryesor - Shkallevë emërgjente të objekteve	cope	1.00	1.00	1.00		
4	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi.	m2	1.00	1.00	1.00		

5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - energjetika instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m2	1.00	1.00	1.00
6	Punimi i projektit kryesor të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike , klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike	m2	1.00	1.00	1.00
7	Punimi i projektit kryesor të instalimeve - Ashensoreve te ndryshem dhe shkalleve levizese.	cope	1.00	0.04	0.04
8	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m2	1.00	2.50	2.50
9	Punimi i projektit kryesor – Rrenimi i objekteve.	m2	1.00	1.00	1.00
C	Hartimi i projekteve për renovim - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.				
1	Incizimi detal i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m2	1.00	6.00	6.00
2	Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m2	1.00	12.50	12.50
3	Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m2	1.00	1.00	1.00
4	Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m2	1.00	1.00	1.00
5	Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m2	1.00	1.00	1.00
6	Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m2	1.00	1.00	1.00

50%

7	Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnizues i ujësjellësit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m'	1.00	1.00	1.00		
8	Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m'	1.00	1.00	1.00		
TOTALI A+B+C:					47.44		412,500.00

C	Kontratat e rregullta të Projekteve për ndërtimin e infrastrukturës rrugore.	KATEGORIA D+E+F+G 45%					
Pos	Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 45% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë D+E+F+G
D	<i>Hartimi i projekteve për Terene Sportive te hapura - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.</i>						
1	Projektimi i tereneve sportive - të hapura	m ²	1.00	1.00	1.00		
2	Projektimi i shesheve (me fontana, gjelbrim, parkingje, shetitore etj.)	m ²	1.00	1.00	1.00		
3	Projektimi i parqeve, kendeve per femije etj.	m ²	1.00	3.00	3.00		
E	Hartimi i projekteve për Rrugë dhe objektet e rruges - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren , dhe LIDAR						
1	Projektim i rrugëve	m'	1.00	9.30	9.30		
2	Projektimi i trotuareve	m'	1.00	3.70	3.70		
3	Projektimi i Urave deri 10 m	m'	1.00	1.00	1.00		
4	Projektimi i Urave mbi 10 m	m'	1.00	1.00	1.00		


5	Projektimi i Mureve Mbrojtëse nen 2m lartesi	m'	1.00	0.60	0.60
6	Projektimi i Mureve Mbrojtëse mbi 2m lartesi	m'	1.00	0.60	0.60
7	Projektimi i rrethojave te oborreve apo parcelave.	m ²	1.00	1.00	1.00
8	Projektimi i sinjalizimit te rrugëve	m'	1.00	2.50	2.50
9	Projektimi për rregullimin e nyjeve te komunikacionit, rreth-rrotullimeve etj.	cope	1.00	1.00	1.00
10	Projektimi i mbikalimeve	cope	1.00	1.00	1.00
11	Projektimi i nenkalimeve	cope	1.00	1.00	1.00
12	Projektimi i parkingjeve te hapura.	m ²	1.00	2.00	2.00
F	Hartimi i projekteve për Trajtim te Ujerave - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren ,dhe LIDAR				
1	Projektimi i Kanalizimit Fekal	m'	1.00	8.90	8.90
2	Projektimi i Kanalizimit Atmosferik	m'	1.00	1.00	1.00
3	Projektimi i Rrjetit te Ujësellsit	m'	1.00	3.50	3.50
4	Projektimi i shtratit të perroit / lumenjeve	m'	1.00	3.50	3.50
5	Projektimi i Rezervarve te Ujitë	m ³	1.00	1.00	1.00
6	Projektimi i Kanaleve Ujitëse me elemente përcjellese	m'	1.00	1.00	1.00
7	Rrjetit i Kanalizimit Fekal ekzistues - digjitalizimit i rrjeti të kanalizimit	m'	1.00	1.90	1.90
8	Rrjetit te Ujësellsit ekzistues - digjitalizimit i rrjeti të Ujësellsit	m'	1.00	2.00	2.00
G	Hartimi i projekteve për Rrjetet Elektrike, Nriqimet Publike - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.				
1	Projektimi i rrjetit elektrike dhe ndriçimit publik	m'	1.00	2.80	2.80
TOTALI D+E+F+G:					55.30
					24.89
					371,250.00

H	Kontratat e rregullta të Projekteve për ndërtimin e objekteve hidroteknike.	KATEGORIA H5%					
Pos	Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 20% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë D
1	Hartimi i Elaboratit kunder zjarrit.	m'	1.00	8.00	8.00	5%	
2	Projekti i shpronsimit (Elaboratet e shpronesimit)	m'	1.00	8.00	8.00		
TOTALI H:					16.00		41,250.00

VLERA TOTALE E PARASHIKUAR	825,000.00
----------------------------	------------

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Gëzim Sylaj
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2025	Data:	12.06.2025
Vula:		Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8. Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjанuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhrat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresën e menaxherit të Projektit]</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>[shëno vlerën e garancionit të ekzekutimit]</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <i>[shëno shumen]</i> b) Përgjegjësia e pales së tretë <i>[shëno shumen]</i> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <i>[shëno shumen]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumen]</i> e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <i>[shëno shumen]</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>[shëno]</i> Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është <i>[shëno datën]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .